



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
INSTITUTI I KËRKIMIT SHKENCOR TË SPORTIT  
DEPARTAMENTI I PROJEKTEVE DHE TEKNOLOGJISË

**RREGULLORE  
E  
DEPARTAMENTIT TË  
PROJEKTEVE DHE  
TEKNOLOGJISË**

## **PËRMBAJTJA**

### **KREU I – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Statusi i Departamentit të Projekteve dhe Teknologjisë  
Baza ligjore e Rregullores  
Objekti i Rregullores së DPT  
Fusha e veprimit dhe efektet e rregullores së DPT

### **KREU II – ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I DPT**

Autoritetet dhe organet drejtuese të DPT  
Asambleja e Departamentit të Projekteve dhe Teknologjisë  
Drejtuesi i njësisë bazë/ Përgjegjësi i Departamentit  
Drejtuesi i Grupit Mësimor dhe Kërkimor  
Raportimi Vjetor i DPT

### **KREU III – VEPRIMTARITË, FUNKSIONET DHE DETYRAT E DPT**

Fushat e Veprimtarisë së DPT  
Kërkimi shkencor në DPT  
Kontributi i DPT në procesin mësimor të UST  
Shërbimet për të tretë

### **KREU IV – PERSONELI I DPT**

Personeli akademik i DPT  
Punësimi i personelit akademik të DPT  
Të drejtat dhe detyrat personelit akademik të DPT  
Personeli akademik i ftuar  
Veprimtaria që kryen personeli akademik i DPT  
Ngarkesa kërkimore vjetore për personelin akademik të DPT  
Ngarkesa mësimore vjetore në mësimdhënies të personelit akademik të DPT  
Marrëveshja për organizimin e kohës vjetore të punës të DPT/IKSHS  
Përmbajtja e marrëveshjes individuale të personelit akademik të DPT/IKSHS  
Shkeljet disiplinore të personelit të DPT  
Masat disiplinore të personelit të DPT

### **KREU V – VLERËSIMI I CILËSISË**

Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë  
Vlerësimi periodik i veprimtarive kërkimore-shkencore të DPT  
Organizimi i vlerësimit periodik të veprimtarisë kërkimore

### **KREU VI – DISPOZITA TË FUNDIT**

Aktet e miratimit të Rregullores

## **KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 1**

#### **Statusi i Departamentit të Projekteve dhe Teknologjisë**

Departamenti i Projekteve dhe Teknologjisë (DPT) është njësi bazë kërkimore e Institutit të Kërkimit Shkencor të Sportit (IKSHS). Emërtimi zyrtar i DPT në gjuhën angleze është “**Department of Projects and Technology**” dhe akronim “**DPT**”.

### **Neni 2**

#### **Baza ligjore e Rregullores**

Rregullorja e Departamentit mbështetet në Ligjin "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, të ndryshuar, aktet nënligjore, udhëzimet dhe urdhërat që dalin në zbatim të tij, Statutin, Rregulloren e Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe Rregulloren e Institutit të Kërkimit Shkencor të Sportit. Rregullorja është hartuar mbështetur specifikisht edhe në aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë detyrimet akademike kërkimore e mësimdhënien., statusin e stafëve akademike dhe administrative në IAL publike si dhe të gjitha aktet e tjera që rregullojnë procedurat dhe kriteret e kualifikimit të stafit akademik, kërkimin shkencor, publikimet dhe kriteret përkatëse si dhe rregullat mbi standartet e kërkimit, etikën në kërkim përfshirë plagjaturën dhe pronësinë intelektuale.

### **Neni 3**

#### **Objekti i Rregullores së DPT**

1. Kjo rregullore ka si objekt rregullimin e veprimtarisë kërkimore, mësimore dhe administrative të DPT, në kuadrin e IKSHS, në përputhje me misionin, objektivat zhvillimore të IKSHS si dhe pr krijimin e hapësirave të nevojshme për një menaxhim fleksibël të departamentit e të personelit përkatës.
2. Kjo rregullore parashikon rregullat e veprimtarisë së personelit në përputhje me emërtimin e përshkrimet e vendit të punës dhe detyrat sipas përshkrimit në kuadër të statusit në IKSHS si institucion kërkimor-shkencor.
3. Rregullorja parashikon gjithashtu kriteret, rregullat dhe standartet e veprimtarisë kryesore, kërkimit shkencor dhe veprimtarinë mësimore e administrative të DPT dhe marrëdhëniet me njësitë e tjera bazë të IKSHS dhe njësitë e tjera në UST e jashtë saj.

### **Neni 4**

#### **Fusha e veprimit dhe efektet e rregullores së DPT**

1. Fusha e veprimit dhe efektet e kësaj rregullore shtrihen dhe përfshijnë të gjitha strukturat, autoritetet, organet drejtuese dhe personelin e DPT.
2. Kjo Rregullore, pas shqyrtimit në Asamblenë e DPT, miratohet nga Drejtoria e IKSHS dhe në mënyrë përfundimtare nga Senati Akademik i UST-së.

## **KREU II ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I DPT**

### **Neni 5**

#### **Autoritetet dhe organet drejtuese të DPT**

1. Autoriteti drejtues i DPT është Drejtuesi i Departamentit, njësisë bazë.
2. Organi kolegjal drejtues i DPT është Asambleja e personelit akademik të Departamentit.

## Neni 6

### Asambleja e Departamentit të Projekteve dhe Teknologjisë

1. Asambleja është organi drejtues vendimmarrës i DPT që përbëhet nga i gjithë personeli akademik me kohë të plotë i tij.
2. Asambleja e DPT drejtohet nga Përgjegjësi i Departamentit. Ajo zgjedh Rektorin e UST-së, anëtarët përfaqësues të IKSHS në Senatin Akademik të UST-së, Drejtorin e IKSHS dhe Përgjegjësin e DPT.
3. Asambleja është organ kolegjal vendimmarrës, që shqyrton e miraton programet kërkimore të departamentit, studimet dhe projektet kërkimore, veprimtarinë botuese e shkencore individuale dhe vendimmarrjen që lidhet me angazhimin në procesin mësimor të personelit të DPT në programet e studimit të UST.
4. Asambleja e DPT ka këto funksione e detyra:
  - a. miraton dhe i propozon Drejtorisë së IKSHS planin vjetor të zhvillimit të Departamentit;
  - b. miraton dhe i propozon Drejtorisë ndryshim, riorganizim ose mbyllje njësisish të tjera ne perberje të tije;
  - c. shqyrton dhe i paraqet Drejtorisë propozime për projekte të kërkimit shkencor;
  - d. diskuton e miraton, raportin vjetor të DPT për kërkimin shkencor, angazhimin në mësimdhënie të personelit të saj dhe të veprimtarive të tjera të tij;
  - e. miraton dhe i propozon për miratim Drejtorisë rregulloren e Departamentit dhe aktet e tjera nënligjore të tij;
  - f. detyra të tjera të përcaktuara në aktet rregullatore në fuqi.

## Neni 7

### Drejtuesi i njësisë bazë

1. Drejtuesi i njësisë bazë është autoriteti drejtues akademik dhe përfaqësues i saj. Ai zgjidhet nga asambleja e personelit akademik të njësisë bazë, dhe është personel akademik i kategorisë “Profesor” ose ka gradën shkencore “Doktor” (PhD), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në rastet kur nuk ka kandidatë të kësaj kategorie, mund të kandidojë për drejtues edhe lektori, kur ky i fundit mban gradën shkencore “Doktor”.
2. Drejtuesi i njësisë bazë pas zgjedhjes nga ana e Asamblese se Personelit Akademik te Departamentit, emërohet nga drejtuesi i njesise kryesore perkatese. Ai mund të shërbejë në detyrë për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.
3. Drejtuesi i njësisë bazë kryen këto funksione:
  - a. Drejton punën për hartimin e planit kërkimor dhe projekteve në zbatim të tij dhe ndjek zbatimin e tyre;
  - b. Mbikqyr veprimtaritë shkencore në departament, në përputhje me planifikimin vjetor, mban dokumentacionin e veprimtarisë kërkimore të personelit akademik të departamentit, pas raportimeve në analizën vjetore të tij;
  - c. I propozon Drejtorisë kriteret e posaçme të punësimit të personelit akademik për te gjitha kategorite e te punesuarve (me kohë të plotë, të pjesëshme apo të ftuar), pas miratimit në departament;
  - d. Drejtusi i departamentit nuk mund te kerkoje shpalljen e nje vendi te lire pune per staf akademik, ne te gjitha kategorite e te punesuarve (me kohë të plotë, të pjesëshme apo të ftuar), pa patur të evidentuar nevojën për të mbuluar apo përballuar veprimtari apo ngarkesa akademike që nuk mund të mbulohen per shkaqe te ligjeshme nga stafi akademik ekzistues i punesuar me kohe te plote ne departament.
  - e. Ne mbledhje të departamentit diskuton dhe dakorteson parashikimin e veprimtarive kërkimore-shkencore dhe angazhimin e personelit të DPT në procesin mësimor të

- fakulteteve të UST-së, të dakordësuara paraprakisht midis titullarëve të IKSHS dhe dekanatit përkatës ku realizohet angazhimi. Parashikimi i veprimtarive dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore behet ne perputhje me normat ligjore te percaktuara ne aktet e nxjerra nga Ministria Pergjegjese per Arsimin e Larte ne Republikën e Shqipërisë, Statuti, Rregullorja e UST dhe Rregullorja e IKSHS. Ne përcaktimin e ngarkesës mësimore sipas marrëveshjeve vjetore të IKSHS me Fakultetet, mbahet parasysh qe stafi akademik me kohe te plote te mbuloje sipas kualifikimit dhe ekspertizes se tij dhe qe stafi i DPT te mbuloje sipas ekspertizes ne vazhdimesi te njejtat lende e module duke krijuar keshtu kushtet per nje ekspertize me te specializuar ne to.
- f. Mbikqyr realizimin e veprimtarive vjetore të personelit akademik përkatës, ne perputhje me planifikimin vjetor te ngarkeses se punes te stafit akademik sipas aktmarreeshjes vjetore indiuduale, mban dokumentacionin e veprimtarive akademike të personelit akademik të departamentit, harton raportin e analizës vjetore të njësisë i cili miratohet në mbledhjen e hapur te departamentit, Asamblenë e DPT, event ku ftohen të marrin pjesë edhe autoritetet drejtuese të IKSHS.
  - g. Organizon analiza periodike për raste e aspekte të veçanta në departament dhe analizën vjetore të punës mësimore shkencore të tij;
  - h. Ngre dhe drejton grupin e punës për hartimin e rregullores së njësisë bazë;
  - i. Në emër të departamentit bën përpjekje të vazhdueshme për krijimin e lidhjeve me institucione homologe dhe për promovimin e departamentit;
  - j. bën të njohur arritjet e departamentit nëpërmjet nxitjes së botimeve informative e shkencore, përfshirjes ose bashkëpunimit në projekte, etj.
  - k. Kryen çdo funksion tjetër të parashikuar në aktet rregullatore të UST-së dhe Rregulloren e IKSHS-së.
4. Mandati i përgjegjës të zgjedhur, të njësisë bazë, mbaron para kohe në rastet:
    - a. kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
    - b. kur jep dorëheqjen;
    - c. e pamundësisë për të kryer detyrën;
    - d. e shkeljeve të rënda të ligjit;
    - e. kur bëhet i paaftë nga ana fizike apo mendore për të ushtruar funksionin;
    - f. kur largohet nga universiteti ;
    - g. kur përfiton lejen sabatike.
  5. Referuar Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Drejtori i propozon rektorit shkarkimin e përgjegjës të njësisë bazë në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së UST-së. Rektori shprehet brenda një muaji. Zëvendësuesi i përgjegjës të njësisë bazë caktohet nga rektori, me propozimin e Drejtorit të IKSHS. Rektori shpall zgjedhje të parakohshme brenda gjashtë muajve nga data e shkarkimit.

## **Neni 8**

### **Drejtuesi i Grupit Mësimor dhe Kërkimor**

1. Përgjegjësi i kërkimor-shkencor përzgjidhet sipas përcaktimeve të Statutit të UST-së. Me propozim të Përgjegjës të DPT, Drejtori i Institutit emëron përgjegjës in e grupit mësimor e kërkimor pas konkurimit të hapur mes anëtarëve të njësisë bazë përkatëse.
2. Detyrat e tij përcaktohen në Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Statutin e Rregulloren e UST-së:
  - a. Mbikqyr procesin kërkimor të grupit që drejton dhe i bën raport vjetor drejtuesit të njësisë bazë për realizimin e tij, duke pasqyruar dhe mendimin e grupit kërkimor.

- b. Drejton dhe ndjek veprimtarinë shkencore të anëtarëve të grupit mësimor dhe kërkimor dhe informon rregullisht në njësinë bazë. Organizon analizën vjetore të kësaj pune në grup dhe depoziton në departament dokumentacionin e veprimtarisë shkencore të secilit anëtar.
  - c. Përgatit informacione për probleme pune të ngarkuara nga drejtuesi i njësisë bazë.
  - d. Informon drejtuesin e njësisë bazë për mungesa të papritura në procesin mësimor dhe kërkimor gjatë vitit dhe për shkeljet e disiplinës mësimore.
3. Mandati i përgjegjësit të zgjedhur të grupit mësimor- kërkimor, mbaron para kohe në rastet:
- a. kur nuk kryen funksionin dhe detyrat e ngarkuara
  - b. kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
  - c. kur jep dorëheqjen;
  - d. e pamundësisë për të kryer detyrën;
  - e. e shkeljeve të rënda të ligjit;
  - f. kur bëhet i paaftë nga ana fizike apo mendore për të ushtruar funksionin;
  - g. kur grupi i ngritur për qëllime mësimore apo kërkimore shkrihet;
  - h. kur largohet nga universiteti ;
  - i. kur përfiton lejen sabatike.

### **Neni 9**

#### **Laboratorët e DPT**

Pranë DPT/IKSHS funksionojnë tre laboratorë eksperimentalë-kërkimorë:

- a. Laboratori i Biologjisë, Biokimisë dhe Gjenetikës së Ushtrimit
- b. Laboratori i Fiziologjisë së Ushtrimit
- c. Laboratori i Biomekanikës

Këta laboratorë administrohen në cilësinë dhe me statusin e njërive ndihmëse të UST, nën përgjegjësinë e IKSHS përmes Departamentit të Projekteve dhe Teknologjisë.

### **Neni 10**

#### **Shërbimet dhe funksioni i laboratorëve kërkimorë**

Laboratorët eksperimentalë-kërkimorë shërbejnë për kryerjen e studimeve e kërkimeve në fushat kërkimore të DPT/IKSHS e UST-së, për realizimin e programeve kërkimore e projekteve të miratuara nga organet vendimmarrëse të njërive kryesore e UST.

- a. Laboratorët shërbejnë për kryerjen e veprimtarisë eksperimentale të programeve kërkimore të studentëve të programit të Doktoratës në UST.
- b. Në këta laboratorë kryhen gjithashtu testime e analiza në shërbim të studimeve e projekteve në bashkëpunim me njësitë e tjera kryesore në UST, apo me institucione të tjera vendase e të huaja.
- c. Në laboratorët kërkimorë mund të kryehen edhe seanca të veçanta demonstruese me studentë të kurseve të avancuara të studimit që kanë në objektin e formimit Biologjinë, Biomekanikën, Analizën e Lëvizjes dhe Fiziologjinë e Ushtrimit.
- d. Laboratorët kërkimorë mund të ofrojnë dhe shërbime për të tretë, në përputhje me rregulloren specifike të funksionimit të tyre dhe përkundrejt tarifave të përcaktuara nga Senati dhe Këshilli i Administrimit të UST.

### **Neni 11**

#### **Administrimi dhe rregullat e funksionimit e përdorimit të laboratorëve**

1. Laboratorët administrohen nën përgjegjësinë e personave të ngarkuar si me poshtë:
  - a. Një anëtar i personelit akademik që përzgjidhet mes punonjësve dhe specialistëve të Departamentit të Projekteve dhe Teknologjisë të IKSHS, në bazë të nivelit arsimor,

- aftësive profesionale dhe përputhshmërisë se formimit dhe specilizimit të tyre me objektin dhe natyrën specifike të fushës së aplikimit të laboratorëve.
- b. Specialisti/laboranti i seicilit laborator përkatës - (personel ndihmës-kërkimor).
  2. Personeli akademik përgjegjës i laboratorit i përgjigjet në mënyrë të drejtpërdrejtë Drejtorit në lidhje me mirëfunksionimin dhe mbarëvajtjen e laboratorit duke garantur e certifikuar zyrtarisht cilësinë e rezultateve shkencore laboratorike.
  3. Laboratorët ndodhen në mjedise të veçanta e të veçuara të UST-së, ku kryejnë veprimtarinë vetëm personat përgjegjës si më sipër.
  4. Personat e tjerë të paautorizuar, mund të frekuentojnë dhe/ose përdorin laboratorët vetëm kur janë autorë, bashkëpunorë të kërkimeve që kryhen, dhe në çdo rast me kërkesë të argumentuar tek drejtuesi i departamentit i cili ja percjell Drejtorit të IKSHS për të leshuar autorizimin e venien në dispozicion të laboratorit dhe personave që kanë në përgjegjësi administrimin dhe funksionimin e tijë.
  5. Kushtet e sigurisë, higjenës dhe standarteve të tjera specifike sigurohen sipas standarteve më të mira të cilësisë dhe kuadrit legjislativ në fuqi rreth tyre dhe çertifikohen nga institucionet shtetërore që kontrollojnë e çertifikojnë këto standarde.
  6. Nëse personat përgjegjës të ngarkuar për menaxhimin dhe funksionimin e laboratorit, konstatojnë që për shkaqe të përligjura laboratorit nuk i plotëson këto standarde, hartojnë me shkrim një raport të detajuar për Drejtorin e IKSHS.
  7. Për administrimin dhe rregullat e veçanta të funksionimit dhe përdorimit të laboratorëve, Departamenti i Projekteve dhe Teknologjisë harton një rregullore specifike, e cila shqyrtohet në Asamblenë IKSHS-së e cila miratohet nga Rektori i UST.

## **Neni 12**

### **Raportimi Vjetor i DPT**

1. Për çdo vit akademik DPT paraqet në Drejtorinë e IKSHS Raportin Vjetor të Veprimtarisë së për vitin përkatës.
2. Raportimi vjetor i DPT duhet të paraqesë të dhëna të qarta dhe transparente të veprimtarisë së tij në zbatim të objektivave e detyrave, të ofrojë informacion për angazhimin e personelit akademik në veprimtaritë e parashikuara kërkimore, didaktike, institucionale e administrative, të paraqesë problemet e konstatuara nga çdo njësi e IKSHS me qëllim zgjidhjen e tyre, në bashkëpunim me strukturat e tjera të UST-së.
3. Raporti vjetor i DPT drejtohet dhe koordinohet nga Drejtuesi i tij. Ai duhet të përmbajë:
  - a. Informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit dhe veprimtaritë në kuadër të kontributit e bashkëpunimit për realizimin e programeve të studimit.
  - b. Raporte të vlerësimit të kërkimit shkencor dhe të gjitha veprimtarive të tjera të kryera nga DPT përgjatë periudhës që mbulon raportin, duke specifikuar grupet/personat përgjegjëse dhe afatet përkatëse për këto realizime.
  - c. Informacion mbi bashkëpunime ndër-departamentore dhe projekte ku merr pjesë DPT me të dhënat përkatëse mbi njësinë bashkëpunuese dhe projektin, fusha e bashkëpunimit; detyrat e palëve dhe produktet, rezultatet apo përfitimet që priten nga ky bashkëpunim.
  - d. Produktet në fushën e kërkimit shkencor të paraqitura në formën e botimeve shkencore, artikujve, projekteve të fituara dhe të realizuara, pjesëmarrjes në veprimtari brenda dhe jashtë vendit, veprimtari shkencore të organizuara nga njësi bazë, bashkëpunime me institucione të tjera në nivel vendor, kombëtar apo ndërkombëtar të shoqëruara me të dhëna mbi datën, vendin dhe pjesëmarrësit;

## **KREU III**

### **VEPRIMTARITË, FUNKSIONET DHE DETYRAT E DPT**

#### **Neni 13**

##### **Fushat e Veprimtarisë së DPT**

1. DPT, si njësi bazë me profil kryesisht kërkimor dhe shkencor e IKSHS ka si objektiv kryesor hartimin, zhvillimin dhe promovimin e platformave, programeve dhe projekteve të kërkimit shkencor në fushat kërkimore të saj dhe mbështetjen e kontributin për arsimimin e thelluar e të avancuar që kanë si komponent dominant kërkimin.
2. DPT ushtron veprimtarinë e tij në këto drejtime kryesore:
  - a. Hartimin, koordinimin e zhvillimin e projekteve në nivel njësisë, IKSHS dhe UST në nivel kombëtar e ndërkombëtar;
  - b. Analiza dhe vlerësimin e gjendjes së tregut të punës në fushën e sportit, aktivitetit dhe edukimit fizik, legjislacionin ekzistues dhe përmirësimin e tij;
  - c. Analiza dhe vlerësimi i praktikave ekzistuese menaxhuese të institucioneve e organizatave sportive;
  - d. Kërkimin dhe studimin për nxitjen dhe promovimin e modeleve më efektive të drejtimit dhe menaxhimit të tyre;
  - e. Studime që lidhen me njohuritë e reja, protokollet shkencore, teknologjitë e avancuara dhe përhapjen e tyre tek stafi akademik dhe studentët, brenda dhe jashtë institucionit e UST-së;
  - f. Fusha të tjera që kanë të bëjnë me objektin kryesor të këtij departamenti e në përputhje me platformat institucionale të kërkimit dhe mësimdhënies.

#### **Neni 14**

##### **Kërkimi shkencor në DPT**

DPT, në kuadër të IKSHS kryen veprimtari kërkimore-shkencore, zhvillimi dhe inovacioni. IKSHS mbështet dhe bashkëpunon gjithashtu për realizimin e programeve të studimit që ofrohen nga fakultetet e UST si dhe shërbime për të tretë.

1. Njësia bazë, mbështetur në propozimet e asamblesë së saj akademike, si dhe në përputhje me Strategjinë e Kërkimit në rang të UST-së dhe IKSHS-së, përcakton fushat bazë të kërkimit në departament, si dhe prioritetet e kërkimit shkencor në terma afatshkurtër dhe afatmesëm.
2. DPT, mbështetur në propozimet e asamblesë së saj akademike, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, përcakton fushat bazë të kërkimit në departament, si dhe prioritetet e kërkimit shkencor në terma afatshkurtër dhe afatmesëm.
3. DPT harton planin vjetor të kërkimit brenda muajit shtator të çdo viti akademik, dhe ja paraqet atë Drejtorit të IKSHS. Veprimtaritë e parashikuara e të miratuara, pasqyrohen në marrëveshjet individuale të punës së cdo antari të personelit akademik të DPT.
4. DPT zhvillon veprimtarinë e vet në bazë të programeve kërkimore e të projekteve shkencore vjetore dhe shumëvjeçare. Projektet hartohen në fillim të cdo viti akademik dhe, pasi diskutohen, miratohen në strukturat vendimmarrëse të IKSHS.
5. Projektet kërkimore hartohen në përputhje me objektivat zhvillimorë të IKSHS, fushave e nënfushave kërkimore të vetë DPT dhe ose në kuadër të propozimeve apo ofertave për bashkëpunim në projekte madhore kombëtare apo ndërkombëtare të fushës. Projektet në rang departamenti, individuale ose grupore, shqyrtohen e miratohen në bazën e udhëzimeve mbi drejtimit kryesore kërkimore institucionale dhe brenda mundësive financiare të vena në dispozicion për periudhën e përcaktuar.
6. Projektet kërkimore, të klasifikuara sipas përgjegjësisë individuale, bëhen pjesë e kontratës shkencore individuale vjetore të personelit kërkimor në parashikimin vjetor dhe në



- Ilogaridhenien në përfundim të vitit akademik. Për projektet disa vjecare, raportimi bëhet në disa faza si i pjesshëm dhe përfundimtar në fund të periudhës së parashikuar.
7. Për realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore apo kontributin në procesin mësimdhënës, DPT bashkëpunon me njësitë e tjera bazë të IKSHS apo të fakulteteve të UST, me njësi bazë ose kryesore të institucione të tjera të arsimit të lartë të vendit dhe të huaja. Ky bashkëpunim kryhet në bazë të marrëveshjeve institucionale dhe/ose individuale, që parashikojnë pjesëmarrjen e punonjësve shkencorë në procesin mësimor dhe/ose përfshirjen e tyre në projekte e programe të përbashkëta kërkimore-shkencore.
  8. DPT shfrytëzon të gjitha mjetet dhe hapësirat e saj për të siguruar vlerësimin, promovimin dhe mediatizimin e rezultateve të veta shkencore përmes veprimtarive shkencore, si dhe përmes formave të tjera të njohura të informimit e diseminimit shkencor e kulturor.
  9. Veprimtaria kërkimore-shkencore në DPT kryhet në përputhje me aktet rregullatore për Etikën në Veprimtarinë Kërkimore dhe Botuese

### Neni 15

#### Fushat kërkimore të DPT

1. Në të gjithë veprimtarinë e saj IKSHS mbështetet në parimin e lirisë akademike e kërkimore. Parimet udhëheqëse në këtë veprimtari janë e vërteta shkencore, e dokumentuar shkencërisht mbi bazën e të dhënave, fakteve reale dhe të verifikueshme, dhe/ose e formuluar mbi bazën e konkluzioneve logjike shkencore. Arritjet e veprimtarisë kërkimore-shkencore të DPT në kuadër të IKSHS dhe produktet e rezultatet e kësaj veprimtarie vihen në shërbim të shoqërisë, në shërbim të zhvillimit të mëtejshëm të institucionit, si dhe në shërbim të kualifikimit të vazhdueshëm të punonjësve shkencorë e të studentëve.
2. Fushat kryesore të kërkimit shkencor që lëvrohen në kuadër të veprimtarisë kërkimore së DPT janë në kuadër dhe në zbatim të fushave kërkimore të përcaktuara në Platformën e Kërkimit të UST për IKSHS, të miratuara nga Senati Akademik.
3. Departamenti i Projekteve dhe Teknologjisë ka fokusin e tij kryesor në rolin dhe rëndësinë e Aktivitetit Fizik për shëndetin dhe cilësinë e jetës në grupe të moshave të ndryshme, përfshirë këtu dhe subjektet që zhvillojnë aktivitetet fizik intensiv dhe sportiv, studime dhe njohjen e sensibilizimin në lidhje me përfitimet e Aktivitetit Lëvizor për parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve të ndryshme kronike, të lidhura ose jo me moshën, mënyrën sedentare të jetesës si dhe faktorët që ndikojnë to, si dhe promovimin e shëndetit përmes të ushtruarit dhe aderimin e përkushtimin ndaj të ushtruarit fizik.
4. Departamenti i Projekteve dhe Teknologjisë (DPT) zhvillon veprimtarinë kërkimore në këto fusha kryesore kërkimi:
  - a. Hartimin, koordinimin e zhvillimin e projekteve në nivel njësisë, IKSHS dhe UST në nivel kombëtar e ndërkombëtar;
  - b. Analiza dhe vlerësimin e gjendjes së tregut të punës në fushën e sportit, aktivitetit dhe edukimit fizik, legjislacionin ekzistues dhe përmirësimin e tij;
  - c. Analiza dhe vlerësimi i praktikave ekzistuese menaxhuese të institucioneve e organizatave sportive;
  - d. Kërkimin dhe studimin për nxitjen dhe promovimin e modeleve më efektive të drejtimit dhe menaxhimit të tyre;
  - e. Studime që lidhen me njohuritë e reja, protokollet shkencore, teknologjitë e avancuara dhe përhapjen e tyre tek stafi akademik dhe studentët, brenda dhe jashtë institucionit e UST-së;
  - f. Fusha të tjera që kanë të bëjnë me objektin kryesor të këtij departamenti e në përputhje me platformat institucionale të kërkimit dhe mësimdhënies.
5. Temat kërkimore dhe projektet që parashikohen të zbatohen në kuadër të fushave të kërkimit të mësipërme janë, por nuk kufizohen në sa vijon:

- a. Vlerësimi i tregut të punës së Sportit, Edukimit Fizik dhe Aktivitetit Fizik në nivel kombëtar, rajonal e lokal;
- b. Vlerësimi i shkallës dhe llojit të menaxhimit të organizatave sportive në nivel kombëtar dhe laokal;
- c. Vlerësimi i shkallës së besueshmërisë të protolloleve të aplikuara në laboratorët e DPT-së;
- d. Analizimi dhe aplikimi i projekteve që zhvillon BE dhe Federatat Sportive Nërkombëtare, si dhe Komiteti Olimpik Nëderkombëtar;
- e. Analizimi dhe vlerësimi i Historisë së Sportit, Edukimit Fizik dhe Aktivitetit Fizik në vendin tonë;
- f. Analizimi dhe vlerësimi i modeleve të promovimit të sportit dhe aktivitetit Fizik në vendin tonë;
- g. Hartimi dhe zbatimi i programeve speciale të stërvitjes për kategori të ndryshme, në laboratorët e DPT-së;
- h. Të tjera, sipas propozimeve të grupeve kërkimore apo personelit akademik të DPT.

### Neni 16

#### Kontributi i DPT në procesin mësimor të UST

1. Personeli akademik i DPT, krahas veprimtarisë kërkimore-shkencore mund të kontribojë e bashkëpunojë për konceptimin, hartimin dhe realizimin e e programeve të studimit që kanë si objektiva formuese kryesor studime të thelluara me një komponent të vecantë kërkimor, zhvillimor e inovativ.
2. DPT mund të kontribojë e bashkëpunojë për ofrimin e programeve të thelluara studimi për disiplina të veçanta, ose programe të thelluara e me natyrë ndërdisiplinore, që kanë për qëllim ngritjen e nivelit shkencor të doktorantëve të rinj dhe të stafit akademik të universiteteve.
3. Procedurat dhe kriteret për përfshirjen e DPT dhe personelit të saj akedemik në veprimtari të karakterit didaktik e të mësim dhenies kryhen në përputhje të plotë me parashikimet ligjore në përgjithësi për këto programe studimi dhe më në vecanti me përcaktimet në statutin dhe rregulloren e UST, dhe Rregulloret e Njësisve kryesore të UST, përfshirë atë të IKSHS.

### Neni 17

#### Shërbimet për të tretë

1. Në kuadër të Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit, personeli akademik i DPT mund të ofrojë, një sërë shërbimesh për palë të treta të interesuara që përfshijnë:
  - a. Shërbime, testime apo analiza të posacme e specifike që lidhen me fushat apo drejtimet që lidhen me fushat e kërkimit të departamentit;
  - b. të kërkojë ose pranojë oferta për kërkime shkencore të porositura në shërbim të palëve të ineteresuara publike ose private;
  - c. të ofrojë, ekspertizë shkencore e shërbime të tjera që lidhen me fushat e ekspertizës së personelit të saj e që janë brenda fushës së operativitetit të DPT;
  - d. të hartojë materiale informuese shkencore e para-shkencore për institucione shtetërore apo private të interesuara;
  - e. të tjera sipas kërkesave të palëve të interesuara.
2. Tarifat e rregullat për ofrimin e këtyre shërbimeve dhe skema e mënyra e përdorimit të të ardhurave të përfutuara nga këto shërbime, përcaktohen e miratohen sipas akteve rregullatore të UST-së dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

## KREU IV PERSONELI I DPT

### Neni 18

#### Personeli akademik i DPT

1. Personeli akademik në DPT është personel kërkimor-shkencor. Veprimtaria kryesore e parashikuar për këtë personel është kërkimi shkencor, kontributi në mësimdhënie, kontributi institucional dhe profesional.
2. Personeli akademik i DPT sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në:
  - a. Profesorë;
  - b. Lektorë;
  - c. Asistent-lektorë.
3. Departamenti ka detyrimin që të bëjë klasifikimin për personelit akademik përkatës dhe ta rinovojë atë në mënyrë periodike.
4. Raportet midis veprimtarive të ndryshme për personelin akademik të DPT, përcaktohen nga IKSHS sipas përcaktimeve në udhëzimet përkatëse të ministrit përgjegjës për arsimin dhe akteve përkatëse të UST.
5. Ngarkesa e plotë vjetore, e ndarë sipas veprimtarive kryesore për personelin akademik përcaktohet nga IKSHS në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin dhe aktet e UST.
6. Personeli në DPT është i punësuar me kontratë, me kohëzgjatje të pacaktuar ose të caktuar, si edhe me angazhim me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, sipas Statutit, Rregullores së UST-së, Rregullores së IKSHS dhe Rregullores së Rekrutimeve në UST-së ku përcaktohen procedurat dhe kushtet për lidhjen e kontratave me punonjësit sipas cdo kategorie specifike të punësimit.
7. Personeli zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë”, aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi, Statutin, Rregulloret e universitetit dhe të njësive kryesore si dhe të gjitha akteve të tjera të brendshme të UST.
8. Personeli akademik i IKSHS gëzon status dhe trajtim të veçantë, që konsiston në liritë akademike, të drejtat ekonomiko-financiare, detyrimet e përgjegjësitë si dhe garancitë juridike e civile në zbatim të tyre, sipas përcaktimeve në aktet ligjore e nënligjore si dhe Statutin e Rregulloren e UST-së.
9. Personeli akademik i kategorisë “Lektor” dhe “Profesor”, me miratim të Përgjegjës të departamentit ku zhvillon veprimtarinë akademike, ka të drejtën e vitit sabbatik. Ai mund të shkëputet nga angazhimet e institucionit, një herë në shtatë vjet, për periudha kohe deri në një vit, për të punuar për përparimin e tij akademik. Rregullat e vecanta për fitimin e të drejtës pëtvitin sabbatik përcaktohen aktet në fuqi dhe aktet rregullatore të UST e IKSHS.
10. Të drejtat dhe detyrimet e personelit përcaktohen në aktet rregullatore të UST, Rregulloren e IKSHS, në këtë rregullore, si dhe në kontratat individuale të punës, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

### Neni 19

#### Punësimi i personelit akademik të DPT

1. Punësimi i personelit akademik bëhet me kohë të plotë, kohë të pjesshme, të ftuar apo përmes lëvizjeve paralele brenda dhe midis njësive bazë apo kryesore të UST-së . Këto kryhen duke u bazuar në aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, si dhe legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punës.
2. Për personelin kërkimor të DPT, si njësi bazë në IKSHS, përveç kritereve të përgjithshme dhe akademike të përgjithshme të parashikuara në aktet ligjore, nënligjore dhe specifike të

UST, aplikohen kritere specifike shtesë që lidhen me natyrën, shkallën e kualifikimit dhe ngarkesën e vecantë kërkimore që ky staf kërkohet të mbulojë.

3. Në rekrutimin e këtij personeli përfshihen dhe kritere që lidhen me:
  - a. Nivelin e kualifikimit shkencor të personelit të kërkuar;
  - b. Përvojën e mëparshme kërkimore në fusha që lidhen me vendin e punës;
  - c. Përvojën në institucione të arsimit të lartë ose kërkimore;
  - d. Përvojë në drejtime projektesh, bashkëpunime me jashtë apo bashkëpunime në veprimtari në zë të fushës;
  - e. Veprimtari të mëparshme botuese, kërkimore në revista shkencore e periodikë vendas e të huaj;
  - f. Kritere të tjera sipas vendit të punës vacant;
  - g. Kërkesat e veçanta vendosen në njoftimin e konkurrimit për vendin e lirë të punës, mbështetur në pozicionin dhe në përshkrimin e vendit të punës. Këto kërkesa përcaktohen nga njësitë përkatëse, ku hapet vendi i lirë i punës.

## **Neni 20**

### **Të drejtat dhe detyrat personelit akademik të DPT**

1. Personeli akademik i Departamentit të Projekteve dhe Teknologjisë ka këto të drejta:
  - a. Të përparojë në karrierën akademike, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
  - b. Të trajnohet, të kualifikohet në institucionet akademike e kërkimore shkencore, brenda dhe jashtë vendit, sipas legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me profilin;
  - c. Të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet e IKSHS dhe UST-së, duke kryer veprimtari zgjedhore në përputhje me statutin dhe rregulloret e tjera të institucionit;
  - d. Të shfrytëzojë të gjitha mundësitë ekzistuese në universitet, institut e departament, duke respektuar të gjitha rregullat e vendosura;
  - e. Të kërkojë nga organet drejtuese të departamentit, institutit, e universitetit, respektimin prej tyre të të gjitha të drejtave që u siguron atyre Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, Ligjin "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, Statutin e Rregulloren e UST-së dhe kuadrin rregullator në fuqi.
2. Personeli akademik i IKSHS ka këto detyra dhe përgjegjësi:
  - a. Të njohë, të respektojë, të zbatojë dhe të veprojë në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
  - b. Të respektojë kohën në funksion të kërkimit shkencor dhe mësimdhënies sipas marreveshjes së punës akademiko-shkencore të vitit akademik. Koha e punës, kërkimit, mësimdhënies dhe të veprimtarive të tjera përcaktohet nëpërmjet kontratës së punës dhe marreveshjes vjetore të personelit akademik;
  - c. Të rrisë aftësitë profesionale akademike dhe të marrë pjesë në veprimtari formuese për këtë qëllim;
  - d. Të mos kërkojë ose pranojë asnjë përfitim pasuror, për kryerjen e detyrave akademike, me përjashtim të pagës dhe privilegjeve të tjera, të përcaktuara me ligj, akte nënligjore dhe aktet e brendshme të UST-së;
  - e. Të mbajë përgjegjësi të plotë për veprimet e tij, gjatë kryerjes së detyrës si personel akademik në IKSHS;
  - f. Të zbatojë etikën institucionale në respektim të imazhit të institucionit dhe figurës profesionale ;
  - g. Të zbatojë kodin e etikës , gjatë kohës së ushtrimit të veprimtarisë akademike;
  - h. Të gjitha detyrimet e tjera që lidhen me angazhimin e personelit akademik kërkimor në mësimdhënie, sikurse të përcaktuara në aktet rregullatore të UST, rregulloret e fakulteteve përkatëse dhe Rregulloren e IKSHS.

## Neni 21

### Personeli akademik i ftuar

1. Njësia bazë ka të drejtë të kërkojë angazhimin dhe/ose punësimin me kontratë për periudha të shkurtra kohe për studiues, personalitete, shkencore sportive vendas ose të huaj. Personeli i ftuar përbëhet kryesisht nga punonjës me tituj shkencorë.
2. Përzgjedhja e personelit akademik të ftuar bëhet nga Drejtoria e IKSHS, mbi bazën e propozimeve të njësive bazë, pasi të jenë identifikuar projektet apo veprimtaritë ku do të angazhohen, detyrat që ata do të kryejnë, si dhe kualifikimi i kandidatëve.
3. Personeli i ftuar kërkimor janë personalitete të shqura dhe me përvojë të spikatur ndërkombëtarisht në fushat kërkimore studimore që lëvtron DPT.
4. Termat e angazhimit, kontrata e punës dhe shpërblimi financiar bëhet sipas akteve ligjore e nenligjore ne fuqi.

## Neni 22

### Veprimtaria që kryen personeli akademik i DPT

1. Veprimtaritë që kryen personeli akademik në DPT, si njësi bazë e IKSHS janë:
  - a. Kërkimi shkencor;
  - b. Mësimdhënie;
  - c. Kontribut institucional;
  - d. Kontribut profesional;
2. Kontributi në kërkimin shkencor përfshin veprimtari të mirëfilltë kërkimore në kuadër të projekteve shkencore institucionale, kombëtare e ndërkombëtare, pjesëmarrje në aktivitet shkencore kombëtare e ndërkombëtare, veprimtari botuese shkencore si artikuj shkencorë e monografi, pjesëmarrje në borde shkencore, angazhim në kuadër të programeve ë Doktoratës dhe kontribut në përgatitjen e projekteve në kuadër të thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare.
3. Mësimdhënia përfshin veprimtari në auditor dhe veprimtari jashtë auditorit, në mbështetje të procesit mësimor, të përcaktuara në elementë didaktikë të mësimdhënies frontale dhe të përgatitjes, vlerësimit të studentëve, etj.
4. Kontributi institucional, përfshin veprimtarinë akademike dhe administrative në mbështetje të njësive bazë, njësive kryesore, institucionit dhe administratës publike.
5. Kontributi profesional përfshin veprimtari për zhvillim dhe transferim teknologjie, ekspertizë e trajnime profesionale të thelluara,e të tjera.
6. Elementët, ngarkesat, dhe zërat përkatës për secilën nga kategoritë e veprimtarive të personelit të DPT, përcaktohen në aktet rregullatore të UST dhe specifikuhen në Rregulloren e IKSHS.

## Neni 23

### Ngarkesa kërkimore vjetore për personelin akademik të DPT

1. Çdo anëtar i personelit akademik i punësuar me kohë të plotë në DPT/IKSHS, duhet të përmbushë detyrimet për kohën vjetore të punës prej 1536 orë.
2. Personeli akademik i DPT është personel i kategorisë kërkimor-shkencor. Për këtë arsye veprimtaria që ze pjesën dërrmuese të ngarkesës së tij vjetore është kontributi që ai jep në Kërkimin Shkencor.
3. Kontributi në kërkimin shkencor përfshin, veprimtaritë e mirëfillta kërkimore në kuadër të projekteve të kërkimit, angazhimi e pjesëmarrja në aktivitete shkencore kombëtare e ndërkombëtare, publikimet shkencore të llojeve të ndryshme, pjesëmarrja në borde e trupa shkencore, përgatitjen e projekteve ndërkombëtare, etj.konferenca, seminare, kongrese, ëorkshope, etj.
4. Veprimtaria kërkimore zë rreth 70% (deri në 1000 orë) të ngarkesës vjetore të punës së

personelit akademik të IKSHS, por në cdo rast sipas përcaktimeve në aktet e brendshme të UST dhe Rregulloren e IKSHS.

5. Personeli akademik me kohë të plotë i DPT, mund të përfshihet në grupet e punës për hartimin dhe aplikimin e projekteve të financuara nga programet e Bashkimit Evropian. Ngarkesa e paguar për përfshirjen në këto grupe pune është deri në 200 orë/projekte në vit. Për shkrimin e projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian, grupit të punës i njihen deri në 350 orë të cilat ndahen ndërmjet anëtarëve të grupit të punës i cili është angazhuar për përgatitjen e projektit. Grupi i punës miratohet nga drejtuesi i njësisë bazë dhe Drejtori i IKSHS.

#### Neni 24

##### **Ngarkesa mësimore vjetore në mësimdhënies të personelit akademik të DPT**

1. Ngarkesa mësimore vjetore e normuar për personelin akademik të DPT që angazhohet në mbështetje të mësimdhënies në kuadër të programeve të studimit të ofruar nga fakultetet e UST është sa 30% e ngarkesës së normuar sipas kategorisë të stafit akademik si dhe të autoriteteve drejtuese të tij.
2. Ngarkesa e normuar mësimdhënëse për personelin me kohë të plotë të DPT, sipas kategorive të personelit akademik, është si më poshtë:
 

|                                |                    |
|--------------------------------|--------------------|
| a. Përgjegjës departamenti     | 27 orë mësimore    |
| b. Kategoria “Profesor”        | 42 orë në auditor  |
| c. Kategoria “Lektor”          | 50 orë në auditor  |
| d. Kategoria “Asistent-Lektor” | 59 orë në auditor. |
3. Çdo orë e realizuar mbi normat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, konsiderohet e kategorizohet si orë suplementare. Orët suplementare në auditor në të cilat mund të angazhohet personeli akademik i DPT nuk mund të jenë më shumë se 100 orë. Personeli akademik i cili angazhohet në mësimdhënie paguhet për ngarkesën e parashikuar si orë suplementare sipas normave ligjore e nënligjore në fuqi.
4. Ngarkesa e plotë mësimore vjetore e një anëtari të personelit akademik me orientim kërkimor-shkencor nuk mund të përmbajë në një vit akademik më shumë se 3 lëndë semestrale në bazë të programeve të përcaktuara nga njësi bazë, sipas përcaktimit të programeve të lëndës ose 2 lëndë vjetore.
5. Çdo angazhim i personelit akademik në veprimtari të pagueshme dhe që nuk është parashikuar dhe miratuar në buxhetin vjetor të UST-së, duhet të marrë përpara ushtrimin të veprimtarisë miratimin e Bordit të Administrimit.
6. Personeli akademik angazhohet në veprimtari kërkimore-shkencore, mësimdhënëse, institucionale, profesionale dhe veprimtari të tjera, në përputhje me fushën e formimit, profilin e kualifikimit të tij akademik, kontratës së punës të lidhur me UST-në dhe marrëveshjen vjetore të aktivitetit akademiko-shkencor.

#### Neni 25

##### **Marrëveshja për organizimin e kohës vjetore të punës për personelin akademik të DPT/IKSHS**

1. Në fillim të çdo viti akademik, çdo punonjës i DPT/IKSHS harton marrëveshjen vjetore të ngarkesës akademike, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe sipas modelit të marrëveshjes së hartuar dhe miratuar më parë nga organet përkatëse.
2. Marrëveshja e ngarkesës vjetore të personelit shërben si platformë kryesore për planifikimin, ndjekjen, realizimin, raportimin dhe vlerësimin e shkallës së përmbushjes dhe cilësisë së cdo antari të personelit akademik të DPT/IKSHS.

3. Modeli i marrëveshjes përditësohet në përputhje me ndryshimet ligjore dhe nënligjore dhe, përpara zbatimit të saj, miratohet fillimisht në Drejtorinë e IKSHS dhe më pas nga Rektori i UST.
4. Secili komponent i ngarkesës përmban tregues dhe kritere që vlerësohen me orë ngarkese pune në raporte midis veprimtarive në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe ku, shumica e të cilave duhet të plotësojë angazhimin vjetor orar të detyrueshëm për personelin akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë.
5. Propozim-Marrëveshja hartohet nga cdo antar i personelit të DPT, e cila shqyrtohet, miratohet/firmoset fillimisht nga Përgjegjësi i Departamentit dhe nga Drejtori i IKSHS.
6. Angazhimet e planifikuara në Marrëveshjen e miratuar, duhet të ndiqen dhe realizohen gjatë vitit akademik vijues. Në rastet kur për arsye objektive, ka ndryshime të veprimtarive të parashikuara, antari i personelit, në dakordësi me Drejtuesin e Departamentit, reflektojnë ndryshimet dhe e paraqesin për miratim nga Drejtori i IKSHS.
7. Në përfundim të vitit akademik, cdo antar i personelit raporton mbi shkallën dhe cilësinë e realizimit, duke shoqëruar cdo veprimtari të deklaruar si të kryer, me dokumentacionin përkatës.
8. Vlerësim i veprimtarive akademike vjetore të personelit të DPT nga ana e Përgjegjësit të Departamentit, kryhet gjithashtu përkundrejt atyre të parashikuara në Marrëveshjen Individuale vjetore të miratuar në fillim të vitit akademik për atë antar të personelit.
9. Për veprimtaritë e mësimdhënies që kryhen në përgjegjësinë e njëjësive përkatëse të UST ku kjo veprimtari zhvillohet, plotësimi i detyrimeve konsiderohet i kryer pas paraqitjes së dokumentacionit zyrtar nga titullari i njësisë përgjegjëse të programit të studimit ku angazhohet antari i DPT.

## **Neni 26**

### **Përmbajtja e marrëveshjes individuale të personelit akademik të DPT/IKSHS**

1. Marrëveshja e ngarkesës vjetore të personelit përmban angazhimin individual në fushën e kërkimit shkencor, mësimdhënien brenda UST, kontributin institucional dhe kontributin profesional. Veprimtaritë e parashikuara në këtë marrëveshje mund të jenë të detyrueshme dhe/ose të rekomanduara, por në cdo rast në përputhje me kuadrin e planit afatshkurtër dhe afatgjatë të veprimtarisë shkencore e akademike në rang departamenti, instituti e institucional.
2. Veprimtaritë që planifikohen, realizohen dhe raportohen, në kontratën individuale duhet të jenë në përputhje me fushën e vet të specializimit dhe me përparësitë afatmesme e afatgjata të departamentit e të Institutit ku bën pjesë dhe të miratuara më parë në institucion. Për çdo aktivitet që del jashtë programeve të kërkimit institucional duhet të paranoftohen ose të rishikohen në kuadrin e marrëveshjes individuale.
3. Realizimi i veprimtarive vjetore shërben si bazë për vlerësimin e performancës akademike dhe kërkimore të stafit të IKSHS. Bazuar në vlerën efektive të realizimeve të secilit punonjës kërkimor, Këshilli e Institutit bën, çdo tre vjet, klasifikimin cilësor të punonjësve shkencorë të Institutit. Për punonjësin kërkimor, i cili nuk i plotëson shkallën e përmbushjes së detyrimeve dhe kriteret e cilësisë, Drejtori në bashkëpunim me Përgjegjësin e Departamentit, propozon ndërprerjen e kontratës së punës, në përputhje me procedurat ligjore në fuqi.
4. Në rastet kur punonjësi angazhohet në projekte bashkëpunuese me të tjerë, të kërkua dhe të miratuara nga IKSHS, ose në projekte shkencore kombëtare a ndërkombëtare, me kërkesën e tij, por që shërbejnë dhe vlerësohen si të vlefshme për institucionin, kontrata shkencore individuale mund të lehtësohet nga disa detyrime, në përputhje me vështirësinë, rëndësinë dhe kohëzgjatjen e projektit/eve.

5. Kriteret minimale të veprimtarive kërkimore, mësimdhënëse dhe në mbështetje të institucionit përcaktohen akte nënligjore specifike të IKSHS/UST dhe përditësohen vit pas viti. Përpara se të aplikohen, ato diskutohen në Drejtorinë e IKSHS dhe miratohen në Senatin Akademik të UST, të paktën 2 muaj përpara fillimit të vitit akademik pasardhës.
6. Marrëveshja individuale lidhet midis personelit kërkimor-shkencor dhe Drejtuesit të Departamentit, dhe miratohet nga Drejtori i Institutit.

### **Neni 27**

#### **Shkeljet disiplinore të personelit të DPT**

1. Përbëjnë shkelje disiplinore veprimet apo mosveprimet si vijon:
  - a. Mosrespektimi në mënyrë të përsëritur i kohës dhe i orarit të punës.
  - b. Moskryerja e detyrave ose mosrespektimi i përsëritur i afateve të caktuara për kryerjen e detyrave;
  - c. Sjellja jo e rregullt gjatë kohës së punës me eprorët, kolegët, vartësit, studentët apo publikun;
  - d. Dëmtimi i pronës së institucionit, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar, apo keqpërdorimi i saj;
  - e. Kryerja, brenda ose jashtë kohës së punës, i veprimeve, të cilat çënojnë interesat e detyrës që ushtron punonjësi në universitet, ose të tilla që pengojnë përmbushjen e saj.
  - f. Shkelja e Rregullores së Etikës;
  - g. Moszbatimi i dispozitave ligjore në përmbushjen e detyrave funksionale;
  - h. Mosrespektimi i detyrave të tjera të parashikuara në statut, rregullore apo akte të tjera me përmbajtje normative që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së universitetit.

### **Neni 28**

#### **Masat disiplinore të personelit të DPT**

1. Në rast të shkeljes së disiplinës në punë mund të merren këto masa disiplinore:
  - a. Tërheqje vëmendjeje (e cila mbahet në procesverbal);
  - b. vërejtje me shkrim;
  - c. paralajmërim për largim nga detyra;
  - d. largim nga puna.
2. Masat disiplinore të përcaktuara përkatësisht në shkronjat (a), (b) dhe (c) mund të shlyhen, në qoftë se brenda një viti nga dita e dhënies së tyre nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore. Masat disiplinore të shlyera hiqen nga dosja personale.

## **KREU V VLERËSIMI I CILËSISË**

### **Neni 29**

#### **Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë**

1. Në kuadër të IKSHS, DPT angazhohet në procesin e brendshëm të sigurimit të cilësisë, në kuadër të Njesise së Vlerësimit të Brendshëm (NJSC) në IKSHS. Ky grup monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive përbërëse dhe personelit.
2. Përfaqësuesi i DPT në NJSC e IKSHS përzgjidhet nga antarët e personelit akademik nga Përgjegjësi i departamentit.



3. NJSC vlerëson veprimtaritë kërkimore dhe plotësimin e standardeve të për këtë qëllim, mbështetur në të dhënat e grumbulluara nga departamenti përmes përfaqësuesit të saj në te.
4. Raportet e vlerësimeve, të kryera nga Njesia Sigurimit të Cilësisë të IKSHS, përdoren si burim për vlerësimin e jashtëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.
5. Mënyra e organizimit të vlerësimit të brendshëm, veprimtaritë që kryhen, përgjegjësitë dhe mënyra e paraqitjes së rezultateve përcaktohen në rregulloret dhe procedurat përkatëse.
6. Standardet për sigurimin e cilësisë në kërkimin shkencor zbatohen në përputhje me Kodin e Cilësisë të hartuar nga ASCAL dhe MASR dhe aktet e institucioneve të vlerësimit të kërkimit në IAL-të si AKKSHI.

### Neni 30

#### Vlerësimi periodik i veprimtarive kërkimore-shkencore të DPT

1. Metodologjia dhe kriteret e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë kryhen në përputhje me përcaktimet e sanksionuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Ky proces ndjek në të njëjtën linjë dhe proces ato të përcaktuara nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) dhe zhvillohet në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet rregullatore të UST dhe specifikisht në Rregulloren e IKSHS.
2. Kriteret që zbatohen për vlerësimin e kërkimit përfshijnë:
  - a. **Kriteri bibliometrik:** lista të publikimeve shkencore të natyrave e llojeve të ndryshme sipas përkufizimeve e klasifikimeve ndërkombëtare;
  - b. **Kriteri i impaktit të veprimtarisë kërkimore-shkencore:** patentat/shpikjet shkencore, projekte e programe kërkimi institucionale, kombëtare e në kuadër të BE-së;
  - c. **Kriteri infastrukturor:** laboratorët kërkimorë, burimet bibliografike profesionale e të profilizuara, abonime, etj;
  - d. **Kriteri i kapaciteteve njerëzore:** kualifikimi akademik e shkencor i personelit, veprimtaria kërkimore, botuese e njësive dhe personelit akademik, pjesëmarrjet në borde shkencore e trupa të mirënjohura të publikimit e vlerësimit të kërkimit në rang ndërkombëtar, etj.;
  - e. **Kriteri i ndërkombëtarizimit:** projektet e përbashkëta ndërkombëtare, angazhimi i personelit në institucionet e arsimit të lartë apo institute kërkimore të vendeve të OECD-së dhe BE-së, e personelit të huaj akademik të njësive bazë nga vendet e OECD-së dhe BE-së, të ftuar pranë njësive bazë, etj.
3. Elementët, kriteret specifike dhe apekte të tjera të këtij procesi duhet të kryhen sipas përcaktimeve në aktet rregullatore të UST dhe Rregulloren e IKSHS.

### Neni 31

#### Organizimi i vlerësimit periodik të veprimtarisë kërkimore

1. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) organizon, administron, monitoron dhe publikon rezultatet e procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë. Vlerësimi për çdo tregues që përbën kriteret e vlerësimit, në nivel njësie bazë, realizohet nëpërmjet një sistemi pikëzimi algoritmik, në mënyrë automatike nga platforma elektronike, Sistemi Shqiptar i Informacionit të Kërkimit Shkencor-ACRIS.
2. Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore shkencore të personelit të departamentit iniciohet nga UST-ja pas marrjes së njoftimit nga AKKSHI. UST, përmes Drejtorit të IKSHS, njofton dhe vendos afate për personelin akademik të njësive bazë, që të realizojë procesin përkatës të plotësimit të të dhënave të kërkuara, në portalin “Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore”, në platformën ACRIS.
3. Drejtuesi i njësive bazë udhëzon, monitoron dhe ndjek të gjitha vetëdeklarimet e të dhënave të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë, duke kërkuar nga të gjithë

- anëtarët përgjegjshëmëri në plotësimin e informacionit, sipas kritereve të përcaktuara në portalin “Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore”.
4. Drejtuesi i njësisë bazë gjatë procesit të vlerësimit duhet që:
    - a. Të caktojë një person kontakti brenda njësisë bazë që të ndjekë procesin e realizimit në afat të vlerësimit;
    - a. Të koordinojë, të monitorojë dhe të ndjekë procesin e hedhjes së të dhënave nga personeli akademik i njësisë bazë brenda afatit të përcaktuar;
    - b. Të paraqesë një raport mbi realizimin e tij Drejtorit të IKSHS mbi zhvillimin korrekt të tij dhe respektimin e afateve të paracaktuara.
  5. Anëtarët e personelit akademik të njësisë bazë do të kenë akses individual të përdoruesit të kodifikuar dhe të mbrojtur, për vetëdeklarimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore të drejtimeve kryesore të fushave të kërkimit dhe të disiplinave specifike.
  6. Drejtuesi i njësisë bazë ka akses individual të përdoruesit të kodifikuar dhe të mbrojtur që shërben për ndjekjen dhe monitorimin e të dhënave të deklaruara nga anëtarët e personelit akademik të njësisë bazë.
  7. AKKSHI është përgjegjëse në bashkëpunim me Qendrën Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), për administrimin e portalit, sigurimin dhe ruajtjen e të dhënave të publikuara, zbatimin e standardeve të përgjithshme të vlerësimit dhe certifikimin e rezultateve të vlerësimit.

## **KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT**

### **Neni 32**

Të drejtën për interpretimin e kësaj Rregulloreje e ka Drejtuesi i Departamentit, Drejtori/Drejtorja e IKSHS dhe Rektori i UST-së.

### **Neni 33**

Rregullorja e Departamentit të Projekteve dhe Teknologjisë miratohet dhe ndryshohet nga Senati Akademik i UST-se me propozim të Drejtuesit të Departamentit, Drejtorit të IKSHS dhe Rektorit të UST-se .

### **Neni 34**

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe e shtrin veprimtarinë duke filluar nga viti akademik 2020 – 2021.